



Kuvendi i Komunës Klinë

Komiteti për Komunitete

01Nr. 06-15091 2023

Klinë, dt 08.05 2023

### PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e punës së Komitetit për Komunitete të mbajtur me datë 03. 03. 2023 në ora 10:00 në Sallën e Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e Komitetit për Komunitete e hapi kryesuesja e Komitetit, znj. Besiana Gashi, e cili përshëndeti të pranishmit dhe prezantoi Rendin e Ditës,

#### RENDI I DITËS

1. Arsyetimi i mungesave.
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit të mbledhjes së fundit.
3. Informim nga drejtorja e shërbimeve publike për gjendjen e vendbanimeve të përmbytura dhe masat që janë marrë.
4. Informim nga zyra për komunitete.
5. Të ndryshme.

Rendi i Ditës u aprovua me të gjitha votat e anëtarëve të Komitetit (6) prezent në mbledhje.

Pika e 1. E Rendit të Ditës: Arsyetimi i mungesave

Të pranishëm në mbledhjen e Komitetit ishin 6 anëtarë të Komitetit.

Pika 2 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.

Procesverbali i mbledhjes së kaluar u MIRATUA pa asnjë votë kundër, pa asnjë abstenim dhe pa asnjë vërejtje.

Pika 3 e Rendit të Ditës.

z. Qendrim Millaku, drejtor i SHP dhe E: Përshëndetje të gjithëve. Me datë 19 Janar kemi marruar informacion nga instituti meteorologjik i Kosovës që do të kemi të reshura në Territorin e Komunës sonë. Posa e kemi marrë këtë informacion jemi be

rast të ngjashëm është edhe në qytet afër hekurudhës. Me këto ankesa a do të merret ndokush? Si do të trajtohen?

z. Qendrim Millaku, drejtor i SHPE: Unë e thash që ka pasur mundësi që komisioni duke u munduar të jetë sa më real ka shkuar pak në minimum. Ne do të provojmë që të bëjmë një raport plotësues bazuar në të gjitha ankesat. Tek Familjet që nuk banojnë në shtëpitë e dëmtuara, komisioni s` ka pas mundësi se si të futet brenda të bëjë vlerësimin. Kemi qenë në një situatë goxha të vështirë edhe ne si komision.

Znj. Marigona Kerellaj: Përshëndetje. Gjatë vizitës në fshatin Shtupel, gjatë vërshimeve në disa familje Kerellaj janë krijuar myk në shtëpi dhe janë bërë të pa banuara. Akoma komisioni vlerësues nuk ka ardhur.

z. Qendrim Millaku, drejtor i SHPE: Nëse ndodhë raporti plotësues do të futet edhe ankesa e juaj. Jemi duke pritur sinjal nga niveli qendror se a mund të kemi raport plotësues.

Pika 4 e Rendit të ditës.

z. Halil Kerellaj, ZKK: Përshëndetje për të gjithë. Sot e zëvendësoj zonjen Silvija Raskovic. Jam munduar që të përmbledh disa pika. Projekti "Itegra" sa jam unë në dijeni në këtë proces, prej të gjithëve sa kanë aplikuar janë 9 persona në rrugë të përfitimit. Një është nga komunitetet. Po ashtu si zyre për komunitete dhe kthim kemi qenë të fokusuar në informim në lidhje me projektin që ka shpall Ministria për komunitete dhe kthim. Kemi ndihmuar në plotësimin e dokumentacionit për aplikantët. Po ashtu me projektin "Advanced together", një nga përfituesit është shkolla e Shtupelit dhe është në proces shkolla në Jagodë dhe një lagje në Poterq ku banojnë komuniteti ku do të instalohet ndritmi publik. Kam qenë shumë i interesuar që të ndihmoj në informim dhe asistim në konkursin që është hapur për policë në Mitrovicën e Veriut. Kemi dërguar 6 persona nga komuniteti ku nga ta 3 e kanë kaluar testin me shkrim. Tek Vërshimet, drejtori posa e theksoi atë që është bërë. Në zyrën tonë ka pasur kërkesa. Fatmirësisht pjesa ku jetojnë komunitetet janë zona kodrinore dhe s` ka pasur shumë dëmtime. Gjithashtu ka pasur kërkesë nga një lagje Egjiptiane në Dresnik që kanë kërkuar të shtrohet ruga me zhavorr dhe në momentin që është lidh kontrata me OE kemi dalë me drejtorin në atë lagje dhe brenda dy ditëve është shtruar rruga prandaj e falënderoj drejtorin me këtë rast. Edhe në shtupe do të mundohemi të bëjmë zgjerimin e kanalizimit dhe të shtrojmë disa rrugë me asfalt.

z. Vehbi Alaj: Sa është asistuar në komunitet në kërkesën për renovimin e shtëpive dhe a është bërë ndonjë vizitë nga ju nëpër lagje e fshatra apo vetëm keni pritur ankesa e kërkesa në zyre?

z. Halil Kerellaj, ZKK: Po , përveç njoftimit në faqe zyrtare kemi pritur palë në zyre dhe kemi dalë në teren. Kam diskutuar gjithmonë me përfaqësues të lagjeve që

Znj. Shukrije Shala: A është në plan që të instalohet ndriçimi publik edhe në fshatin Çeskovë?

Drejtori e ripërsëriti se edhe në fshatin Çeskovë sikurse edhe në të gjitha fshatrat e tjera do të instalohet ndriçimi publik.

Pas zonjës Shala, kryesuesja e komitetit falënderoj të gjithë për kontribut dhe shpalli të mbyllur mbledhjen.

Procesmbajtës:

Skënder Behramaj

